



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës

01.Nr. 109/02-17246 /2020

Kaçanik, .2020

Në mbështetje të buxhetit të komunës si dhe Rregullores të MF - NR – 04/2017

MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE, Komuna e Kaçanikut, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE

Në fushën e Kulturës në vlerë të 16,000.00 €, për vitin 2020.

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të, Shoqëritë Kulturore- Artistike, Organizatat kulturore të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Kaçanikut të cilat janë të dëshmuara për promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore-tradicionale, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2020, si dhe në politikat programore të Sektorit për Kulturë për riorganizimin e rimëkëmbjen dhe pajisjen e tyre me veglave dhe veshje për zhvillimin e aktiviteteve të tyre etj.

Kërkesa për aplikim për të gjitha OJQ-të Kulturore duhet të përmban:

- Projekt Propozimet do të dorëzohen bashkë me koston totale vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me udhëzimet për aplikantët janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Kaçanikut. ;
- Plotësimi i Formularit për aplikim (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>

Kliko : SHPALLJET -----APLIKACIONET -----FORMULARI PËR APLIKIM - KULTURE)

Kërkesës duhet ti bashkangjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Kaçani
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirologaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime organizata ndaj ATK;

Data e aplikimit është nga 29.07.2020 – 12.08.2020

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *OJQ-të duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të*
- *Si dhe ti kenë të përmbyllura të gjitha detyrimet paraprake . Poashtu para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës i OJQ-së dhe menagjeri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

